V E N D I M
Nr.42, datë 23.1.1995

PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJIT NR.7703, DATË 11.5.1993 "PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" DHE TË LIGJIT NR.7870, DATË 13.10.1994 "PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Në zbatim të neneve 2 dhe 9 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" dhe të neneve 4 e 8 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", sigurohen në mënyrë të detyrueshme:

1. Personat e punësuar sipas një kontrate pune që zgjat për më shumë se koha javore e punës. Këta sigurohen për paaftësi të përkohshsme në punë, barrë lindjeje, pensione, aksidente në punë e sëmundje profesionale, papunësi dhe në sigurimin shëndetësor.

2. Punëtorët sezonalë e të përkohshëm, kur punojnë sipas një kontrate pune që zgjat më pak se 3 muaj në vit. Këta sigurohen për paaftësi të përkohshme, barrë lindjeje, aksidente në punë e sëmundje profesionale dhe në sigurimin shëndetësor.

3. Personat që punojnë sipas një kontrate pune për më pak se koha javore e punës gjatë gjithë vitit. Këta sigurohen për aksidente në punë e sëmundje profesionale dhe në sigurimin shëndetësor.

4. Personat e tjerë ekonomikisht aktivë (punëdhënës dhe të vetëpunësuar), të cilët kanë të ardhura nga një veprimtari ekonomike, pavarësisht nga kohëzgjatja e saj. Këta sigurohen për barrë lindjeje, për pensione dhe në sigurimin shëndetësor.

5. Të vetëpunësuarit në bujqësi të aftë për punë që kanë mbushur moshën 16 vjeç dhe që nuk janë të siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë. Këta sigurohen në mënyrë të detyrueshme për lejen e barrës së lindjes, për pensione dhe në sigurimin shëndetësor.

6. Personat me të ardhura të rregullta nga pronësia, sipas deklarimit në zyrën e tatimeve. Këta bëjnë vetëm sigurimin shëndetësor.

II. Në zbatim të neneve 2, 32, 36, 48 dhe 54 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", niveli bazë për vitin 1995 është 2200 lekë.

Në zbatim të nenit 96 të po këtij ligji, kur pensioni do të caktohet nga ligji nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore", niveli bazë për vitin 1995 është 700 lekë në muaj.

III. Në zbatim të neneve 9, 10, 14 dhe 90 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", dhe në zbatim të neneve 8, 9, 10, 11 dhe 12 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", masa e kontributeve minimale e mujore për vitin 1995 është:

1. Kontributet minimale mujore për degët e sigurimit

	Gjer më 28 shkurt 1995 (lekë)	Pas datës 28 shkurt 1995 (lekë)
- Dega e sigurimit të sëmundjeve	48	48
- Dega e sigurimit të barrës së lindjes	88	88
- Dega e sigurimit të pensioneve	1008	1008
- Dega e sigurimit të aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale	16	16
- Dega e sigurimit të papunësisë	190	190
- Dega e sigurimit shëndetësor-		110
Shuma:	1350	1460

2. Për personat e punësuar punëdhënësi derdh kontribut të detyrueshëm në masën 32.5 për qind të listëpagesave mujore në kufijtë e pagesës minimale 3180 lekë dhe maksimale 9540 lekë deri në datën 28 shkurt 1995. Pas kësaj date punëdhënësi derdh kontribut të detyrueshëm në masën 34.2. për qind të listëpagesave mujore në kufijtë e pagave të mësipërme.

Për personat e punësuar, punëdhënësi mban 6 për qind nga paga e tyre në kufijtë e mësipërm të pagave deri në datën 28 shkurt 1995. Pas kësaj date punëdhënësi mban 7.7 për qind nga paga e personave të punësuar në kufijtë e pagave minimale 3180 lekë dhe maksimale 9540 lekë dhe i derdh si kontribut të detyrueshëm së bashku me pjesën e tij.

3. Punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit (duke përjashtuar të vetëpunësuarin në bujqësi) derdhin kontribut të detyrueshëm në masën 34.5 për qind të pagës mujore minimale 3180 lekë (që i përgjigjet kontributit mujor minimal 1096) deri në datën 28 shkurt 1995. Pas kësaj date punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit derdhin kontribut të detyrueshëm në masën 41.5 për qind të pagës mujore minimale 3180 lekë (që i përgjigjet kontributit mujor minimal 1320 lekë).

4. Personat e tjerë (mbi 16 vjeç) me të ardhura të rregullta nga pronësia (dhe që nuk kanë ndonjë punësim tjetër) paguajnë kontribut të sigurimit shëndetësor në masën 7 për qind të pagës mujore minimale 3180 lekë (që i përgjigjet kontributit mujor minimal 223 lekë), duke filluar nga data 1 mars 1995.

5. Të vetëpunësuarit në bujqësi derdhin kontribut vjetor në masën 15 për qind të të ardhurave fikse vjetore 10800 lekë, e barabartë me 1620 lekë. Për rrethet Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë e Tropojë masa e kontributit vjetor do të jetë 9 për qind, e barabartë me 972 lekë deri në 28 shkurt 1995. Pas kësaj date të vetëpunësuarit në bujqësi do të derdhin kontribut vjetor në masën 20 për qind të të ardhurave fikse vjetore 10800 lekë, e barabartë me 2160 lekë. Për rrethet Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë e Tropojë masa e kontributit vjetor do të jetë 12 për qind, e barabartë me 1296 lekë.

Këto kontribute derdhen në bashki, komuna ose në agjencitë dhe degët e bankës tregtare agrare në rrethe e komuna, në favor të buxhetit të sigurimeve shoqërore 3 herë në vit, si vijon:

- Në muajin prill 10 për qind e kontributit vjetor.
- Në muajin gusht 30 për qind e kontributit vjetor.
- Në muajin nëntor 60 për qind e kontributit vjetor.

Të ardhurat për lejen e barrës së lindjes, pensionet, lindjen e fëmijëve dhe për vdekjen paguhen nga bashkitë ose komunat për llogari të fondeve të sigurimeve shoqërore, me paraqitjen e dokumenteve përkatëse të përcaktuara në rregulloret dhe udhëzimet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

IV. Në zbatim të neneve 13 dhe 15 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të neneve 8, 9 dhe 11 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", punëdhënësi detyrohet të paguajë dhe të paraqesë çdo muaj në agjencitë e sigurimeve shoqërore të rrethit listën emërore, pagën mujore, pagën mbi të cilën është derdhur kontributi dhe masën e kontributit të derdhur për çdo të punësuar.

Të vetëpunësuarit në kushte të veçanta të pranueshme mund të paguajnë kontributin një herë në 3 muaj, siç parashikohet në rregulloret e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

V. Në zbatim të neneve 4 dhe 8 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", personat, të cilët mbulohen nga sigurimi shëndetësor i detyrueshëm, do të paraqitin për përfitimin e këtij sigurimi këto dokumente:

1. Personat e punësuar, punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit në fshat e në qytet janë të detyruar të pajisen me librezë të sigurimit shoqëror e shëndetësor, sipas lidhjeve nr.1 dhe nr.2 që i bashkëngjiten vendimit.

2. Personat mbi 16 vjeç, anëtarë të familjes që punojnë e bashkëjetojnë me të vetëpunësuarin dhe nuk kanë ndonjë punësim tjetër, personat me të ardhura të rregullta nga pronësia, pavarësisht nga puna, nenet me leje lindjeje dhe personat e huaj, të punësuar e të siguruar në Shqipëri, janë të detyruar të pajisen me libreza të sigurimit shëndetësor.

3. Pensionistët të paraqesin librezën e pensionit, me të cilën ata tërheqin këstin mujor të pensionit.

4. Të papunët dhe personat që trajtohen me ndihmë ekonomike, të paraqesin vërtetimin e lëshuar nga zyra e punës dhe ndihmës ekonomike e rrethit përkatës, në të cilin të tregohet se është i

papunë ose që trajtohet me ndihmë ekonomike dhe asistencë sociale.

5. Të paaftët (mendorë dhe fizikë) të paraqesin një vërtetim të lëshuar nga zyrat e asistencës sociale, nga të cilat ata trajtohen me ndihmë sociale ose me përfitim paaftësie.

6. Shtetasit që kryejnë shërbimin ushtarak të detyruar, të paraqesin vërtetimin e lëshuar nga dega ushtarake.

7. Fëmijët, nxënësit dhe studentët me shkëputje nga puna të paraqesin vërtetimin e shkollës.

8. Instituti i Sigurimeve Shoqërore përgatit dhe u shpërndan personave juridikë e fizikë, kundrejt pagesës, librezën e sigurimit.

a) Punëdhënësi pajis dhe plotëson librezat e sigurimit të punëmarrësve.

b) Për personat e tjerë pajisja dhe plotësimi i librezës së sigurimit bëhet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

VI. Në zbatim të nenit 59 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të nenit 10 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ardhurat mbi të cilat llogariten e paguhen kontributet janë:

1. Pagat që jep punëdhënësi sipas një kontrate pune.

2. Të ardhurat nga një punë e dytë ose nga një punë tjetër, të cilat raportohen te punëdhënësi kryesor dhe kontributet që rrjedhin prej tyre, nuk duhet të tejkalojnë pagën maksimale të siguruar.

3. Të ardhurat nga vetëpunësimi, pavarësisht nëse personi është i regjistruar.

Nuk quhen të ardhura nga veprimtaria ekonomike dhe nuk u nënshtrohen kontribucioneve përfitimet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore; kompensimi për personat që ka në ngarkim në bazë të vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.310, datë 24.7.1992 dhe nr.274, datë 12.6.1993; kompensimi për shpenzimet nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave; dhuratat dhe të ardhurat nga detyrimi për ushqim sipas Kodit Civil dhe shpërblimet nga fondi i veçantë.

Rregullat për përcaktimin e pagesës për efekt të ligjit "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" dhe të ligjit "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë" vendosen me udhëzim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

VII. Në zbatim të neneve 53, 54, 55, 57, 84, e 85 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipëërisë", për të ardhurat nga papunësia:

1. Për të përfituar të ardhura nga papunësia, personat e siguruar duhet të regjistrohen si të papunë pranë zyrës së punës, të paraqesin kërkesën me shkrim dhe të plotësojnë dokumentacionin përkatës brenda 60 ditëve nga data e lindjes së të drejtës për t'i përfituar këto të ardhura. Në të kundërt ata humbasin të drejtën e përfitimit të të ardhurave nga papunësia, me përjashtim të rasteve kur janë të sëmurë të vërtetuar me raport mjekoligjor.

2. Personi që përfiton të ardhura nga papunësia, detyrohet që një herë në muaj, në datën e caktuar ose sa herë që thirret, të paraqitet në zyrën e punës. Nëse nuk paraqitet pa shkaqe të përligjura, humbet të drejtën e të ardhurave nga papunësia.

3. Personi që përfiton të ardhura nga papunësia dhe punësohet ose vetëpunësohet, detyrohet të lajmërojë zyrën e punës brenda 5 ditëve. Në rast të kundërt paguan shumën e të ardhurave nga papunësia që ka përfituar padrejtësisht.

Leja e ushtrimit të veprimtarisë private jepet nga organi kompetent, pasi të jetë marrë vërtetim nga zyra e punës. Me marrjen e kësaj leje e ardhura nga papunësia ndërpritet.

4. Çdo person, gjatë periudhës që merr të ardhura nga papunësia, detyrohet të informojë zyrën e punës për ndryshimet në gjendjen familjare, nëse personat në ngarkim të tij mbushin moshën 15 vjeç, ose ndryshojnë kushtet e tjera të përfitimit të të ardhurave nga papunësia.

Çdo pengesë e marrë në bazë të informacionit të falsifikuar kthehet.

VIII. Marrëdhëniet administrative e financiare ndërmjet Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit, ISKSH dhe bankave do të rregullohen me akte nënligjore të përbashkëta.

IX. Për zbatimin e këtij vendimi, Institutit të Sigurimeve Shoqërore pas datës 28 shkurt 1995 i shtohen në organikë 200 punonjës me një fond page prej 10 milionë lekësh.

X. Ngarkohen Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe ISKSH të nxjerrin udhëzim për zbatimin e këtij vendimi.

XI. Efektet financiare që lindin nga zbatimi i këtij vendimi duke përjashtuar ato të kapitullit IX, do të programohen dhe përballohen nga buxheti i ministrive dhe institucioneve përkatëse për vitin 1995.

Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.452, datë 16.9.1993, dhe nr.610, datë 31.12.1993, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 1995 dhe për efekt të zbatimit të sigurimit të detyruar shëndetësor, hyn në fuqi më 1 mars 1995.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi